



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**KOMISIONI PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË**

Tiranë, më 02. 11. 2020

Dokument parlamentar

**(Komision për dhënie mendimi)**

**RAPORT**

**PËR PROJEKTLIGJIN “PËR BUXHETIN E VITIT 2021”  
NË PARIM**

Drejtuar: Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në mbledhjen e tij të datës 30 tetor 2020, shqyrtoi projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”, në parim.

Të ftuar për të marrë pjesë në mbledhjen e shqyrtimit në parim të këtij projektligji dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve ishin: Ministrja, Sekretarja e Përgjithshme e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përkatësisht: Znj. Ogerta Manastirliu, Geraldina Prodani dhe Merita Xhafa, zv. Ministrja e Ekonomisë dhe Financave, znj. Dajna Sorensen dhe nga Ministria e Arsimit , Sportit dhe Rinisë Drejtor i Përgjithshëm i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, znj. Mirela Bimo.

Projektligji “Për buxhetin e vitit 2021” është nismë e Këshillit të Ministrave, mbështetur në nenet 78, 83 pika 1 dhe 100, të Kushtetutës dhe në nenin 30 të ligjit nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

Projektbuxheti ka në themel objektivat e kuadrit makroekonomik e fiskal afatmesëm për tri vitet në vijim për ruajtjen dhe konsolidimin e mëtejshëm të stabilitetit makroekonomik të vendit si dhe krijimin e klimës për një rritje të lartë e të qëndrueshme ekonomike. Politikat dhe treguesit e tij, si çdo vit, janë konsultuar me Fondin Monetar Ndërkombëtar. Institucionet financiare ndërkombëtare kanë vlerësuar se ekonomia shqiptare po zhvillohet pozitivisht dhe

me ritme të qëndrueshme, duke arritur një normë më të lartë rritjeje se mesatarja e Ballkanit Perëndimor.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë e shqyrton këtë projektligj, bazuar në nenet 32- 38 dhe 80 të Rregullores së Kuvendit.

Duke qenë se Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë nuk është komision përgjegjës, ky komision e shqyrton këtë projektligj sipas fushës së saj të përgjegjësisë. Konkretisht komisioni do të trajtojë projekt-buxhetin e akorduar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrinë e financave dhe ekonomisë dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

**Prioritetet 2020-2023** të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në sektorin e shëndetësisë do të jenë:

- Financimi i shërbimeve shëndetësore (parësore e spitalore);
- Qëndrueshmëria dhe përmirësimi i situatës financiare institucioneve shëndetësore e të mbrojtjes sociale, nëpërmjet përdorimit me efektivitet të burimeve të financimit, forcimit të kontrollit të shpenzimeve;
- Rritja e kosto-efektivitetit të listës së barnave e pajisjeve të rimbursueshme;
- Financimi i paketave të miratuara të shërbimit spitalor në spitalet publike e jopublike;
- Pagesat për kujdes shëndetësor, sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të nënshkruara;
- Intensifikimi i punës për kostimin e shërbimeve të reja shëndetësore, në kujdesin shëndetësor, me synim ndryshimin e mënyrës së financimit të shërbimeve shëndetësore;
- Financimi i shërbimit të kontrollit bazë mjekësor bazë për të paktën 50% të numrit të shtetasve të moshës 35-70 vjeç.

### **Rezultatet që synohet të arrihen për periudhën afatmesme 2020-2023**

- Mbulimi universal i popullsisë me shërbim shëndetësor duke parashikuar 6.4 milionë numër vizitash në periudhën 2021-2023, mbështetur në treguesit e sëmundshmërisë.
- Ofrimi i shërbimit të kontrollit bazë (check-up) për mesatarisht 475 mijë pacientë në vit;
- Trajtimi me recetë rimbursimi i mesatarisht 400 mijë pacientëve në vit, përgjatë periudhës 2021-2023.
- Rritja e numrit të pacientëve të trajtuar nga 320 mijë pacientë në vitin 2020 në 340 mijë pacientë në vitin 2023;
- Rritja e numrit të pacientëve që përfitojnë nga paketat e kardiokirurgjisë dhe kardiologjisë (200 pacientë më shumë çdo vit, për periudhën 2021-2023);
- Numri i pacientëve përfitues nga shërbimi i dializës për vitin 2020 është 1,346 pacientë, e çdo vit shtohen rreth 150 pacientë. Mesatarisht çdo pacient kryen 13 seanca në muaj. Për periudhën 2021-2023 parashikohet rritje e ndjeshme e numrit seancave

për pacientët që përfitojnë nga trajtimi me dializë nga 215 mijë seanca në vitin 2021, në 252 mijë në vitin 2023;

- Depistimi i dëgjimit neonatal për mesatarisht 11 mijë fëmijë në vit përgjatë periudhës 2021-2023.
- Trajtimi i mesatarisht 25 fëmijëve në vit më Sindromën Down përgjatë periudhës 2021-2023.
- Ulja e nivelit aktual prej 15% të pacientëve të rishtruar për të njëjtën diagnozë brenda 72 orësh, nëpërmjet urgjencës;
- Reduktimit të kohës aktuale prej 45 ditësh të pritjes për ekzaminime të rëndësishme (rezonancë magnetike, skaner etj.);
- Përmirësimi i mëtejshëm i koeficientit të shfrytëzimit të shtretërve më shumë se 49% që rezulton në vitin 2020.
- Mesatarisht 35% më shumë çdo vit gra të depistuar për kancerin e qafës së mitrës, përgjatë 2021-2023 me synim uljen e vdekshmërisë nga kanceri i qafës së mitrës nga 2.9/100 000 në vitin 2021 në 2.7/100 000 në vitin 2023.
- Rritja e numrit të thirrjeve të adresuara në njësitë e Urgjencës mjekësore nga 390 mijë thirrje në vitin 2021 në 410 mijë thirrje në vitin 2023, me një kohë reagimi mesatarisht prej 15 minutash.

### **Prioritetet 2020-2023 për Mbrojtjen Sociale**

Në fushën e mbrojtjes sociale, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale synon zbatimin me sukses të reformës së programit të përkujdesit social në tre shtyllat kryesore të tij: Ndihma Ekonomike, Paftësia e Kufizuar dhe Shërbimet Sociale.

Më konkretisht synohet:

- Numri i familjeve dhe individëve në nevojë që pritet të përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike parashikohet të jetë mesatarisht 66 mijë përfitues në vit përgjatë periudhës 2021-2023.
- Numri i përfituesve nga PAK dhe kujdestarëve të tyre parashikohet të shkojë nga 172.4 mijë në vitin 2021 në 174 mijë në vitin 2023.
- Mbështetja e personave nga grupet e pafavorizuara përmes punësimit në ndërmarrjet sociale synohet që në periudhën 2021-2023, të realizohet duke punësuar 250 persona në vitin 2021, 300 persona në vitin 2022 dhe 350 persona në vitin 2023.
- Gjithashtu, krijimi i fondit social synon mbështetjen e njësisive të vetqeverisjes vendore për ofrimin e 20 shërbimeve të reja sociale territoriale për grupet në nevojë dhe mbështetjen e familjeve të NE me paketa sociale shëndetësore.

### **Implementimi i reformës do të sjellë:**

- Rritjen mbi 80% të numrit të përfituesve të varfër që marrin NE mbi totalin e aplikuesve.
- Rritjen mbi 57% të numrit të personave me aftësi të kufizuar që janë komisionuar përmes sistemit të menaxhimit të informacionit;
- Rritjen mbi 12% të numrit të përfituesve të grave kryefamiljare që marrin Ndihmë Ekonomike mbi totalin e aplikuesve gra kryefamiljare;

- Rritja me më shumë se 66 e numrit të grave dhe vajzave në nevojë të riintegruara pas trajtimit në institucionet e përkujdesit social.

## **Prioritetet 2020-2023 në lidhje me Arsimin profesional dhe punësimin:**

### **Arsimi Profesional**

Reforma për arsimin dhe formimin profesional është fokusuar në garantimin e cilësisë, duke siguruar parimet thelbësore të gjithëpërfshirjes dhe lidhjen/me tregun e punës, pa neglizhuar shkallën e pjesëmarrjes në arsimin dhe formimin profesional për të kapërcyer hendekun që ekziston krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian.

Aktualisht arsimi profesional ofrohet në 35 shkolla publike të arsimit profesional. Këto institucione ofrojnë 25 drejtime mësimore, 86 profile profesionale dhe në total numri i nxënësve në arsimin profesional për vitin 2020-2021 është 17,000 nxënës nga të cilët rreth 2,700 janë vajza.

**Shkalla e punësueshmërisë** së të diplomuarve në arsimin profesional, sipas të dhënave të INSTAT tregon se shkalla e punësimit të personave me arsim të mesëm profesional për vitin 2019 është 68.9% në krahasim me 56,3%, për ata me arsim të mesëm të përgjithshëm, duke theksuar rritjen e mundësive të punësimit për ata që kanë aftësi profesionale .

Trendi i regjistrimeve vijon të jetë konstant në vitet e fundit. Nxënësit që ndjekin arsimin profesional është rreth 17 % aktualisht nga 13 % në vitin 2013.

Në vitin aktual akademik ka një rritje të numrit të nxënësve nga zonat rurale dhe grupeve të marginalizuara. Më konkretisht, pjesëmarrja e romëve dhe egjiptianëve (R/E) u rrit me 11.6% duke arritur në 603 studentë (krahasuar me 568 në vitin e kaluar), ndërsa pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara u rrit nga 128 në 143 nxënës ndërsa nxënësit nga zonat rurale zënë 45.4% të totalit të nxënësve në arsim profesional.

Dixhitalizimi është bërë një element i rëndësishëm i tregut të punës dhe ofruesit e AFP-së po përshtaten që të të përdorin avantazhet e tij për të ofruar mënyra të reja të të mësuarit/mësimdhënies moderne. COVID-19, imponoi ndryshime në zhvillimin dhe implementimin e politikave të reja në fushën e AFP-së e sidomos në dixhitalizimin e sistemit të AFP. Nevojat në këtë fushë janë të konsiderueshme dhe situata e COVID-2019 vuri në dukje se duhet investuar me përparësi në këtë drejtim, si në aspektin e paisjes me infrastrukturë e llogjistikë, ashtu edhe në trajnimin e vazhduar të mësuesve.

Programi Buxhetor i Arsimit të mesëm profesional për vitin 2021 synon të përmbushë objektivat e vendosura në Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

**Objektivat Kryesore** të Programit Buxhetor të Arsimit të mesëm profesional janë :

- Rritja e numrit të të punësuarve pas diplomimit në shkollat e mesme profesionale në 46% të totalit që mbarojnë studimet në vitin 2023, krahasuar me 42% në vitin 2020;
- Rritjen e numrit të nxënësve që vijnë nga zonat rurale të cilët ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, nga 43% e totalit në vitin 2020 në 55% e totalit në vitin 2023;
- Rritjen e numrit të nxënësve me aftësi të kufizuar që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale nga 128 nxënës në vitin 2020 në 140 nxënës në vitin 2023.
- Rritjen e numrit të nxënësve që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale, në 19.5% të totalit të nxënësve që ndjekin arsimin parauniversitar në vitin 2023, krahasuar me 17 % në vitin 2020;

**Buxheti i planifikuar per Programin e Arsimit të mesëm profesional, per vitin 2021 është 3 miliard e 295 milion lek ëme një rritje me 4.1% më shumë se vitin e kaluar**

**Fondet e planifikuara për vitin 2021 ne Arsimin profesional do të bëjnë të mundur realizimin e këtyre aktiviteteve kryesore:**

- Realizimin e nje procesi mesimor cilësor e me kushte optimale të të nxenit, teorik e praktik për ti pajisur nxënësit me kompetencat e duhura.
- Rekrutimi dhe trajnimi i mësuesve ndihmës me qëllim rritjen e aksesit edhe per nxënësit me aftësi ndryshe.
- Ndërtimin dhe rikostruksionin e shkollave dhe Reparteve të praktikave të dëmtuara nga tërmeti.
- Paisjen e shkollave me kompjutera dhe pajisjet e nevojshme për zhvillimin e mësimi, duke përfshirë edhe pajisjet e reparteve të praktikës profesionale me pajisje dhe makineri.
- Rishikimin e programeve ekzistuese dhe hartimin e programeve të reja në përputhje me parimet e barazisë gjinore dhe gjithpërfshirjes në zbatim të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.
- Zhvillimi i kompetencave të mësuesve dhe instruktorëve të AFP-së në përshtatje me zhvillimet e reja teknologjike dhe forcimin e lidhjeve midis të nxënit dhe punës.
- Hartimin e modelit të akreditimit ngritjen e komitetit te pare sektorial,
- Modernizimi i kuadrit ligjor te AFP ekzistues qe rregullojnë sistemin e AFP-se, si dhe aspektet që kanë të bëjnë me AFP-në (hartimi i skeletkurrikulave, materialeve mesimore, trajnimi i mësuesve, etj.) ne zbatim te Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve

## **2. Tregu i Punes**

Qëllimi i politikës së Programit Buxhetor “Tregu i Punës” është rritja e mundësive për punë të denjë, nëpërmjet politikave efikase të tregut të punës, ofrimin e arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit, nxitjen e përfshirjes dhe kohezionit social, si dhe fuqizimin e tregut të punës dhe të sistemit të kualifikimeve.

Objekti i politikës së programit buxhetor “Tregu i Punës është përmirësimi i shërbimeve të punësimit nëpërmjet rritjes të numrit të ndëmjetësimeve, këshillimeve dhe orientimit për karrierë, targetimi i grupeve në nevojë të të papunëve. Përshtatja e kurseve të formimit profesional me kërkesat e tregut të punës. Përmirësimi i sistemit të menaxhimit të migrimit, sipas sandarteve të BE.

Buxheti i planifikuar per Programin Buxhetor “Tregu i Punës” per vitin 2021 është 2,292,000 milion lekë

Hartimi i PBA u bazua në objektivat e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022 dhe në ligjin Nr. 15/2019 “Për Nxitjen e Punësimit”.

Ligji Nr. 15/2019 “Për Nxitjen e Punësimit” përcakton si objektiv rritjen e punësueshmërisë së forcave të punës, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe programeve publike të punësimin, të vetëpunësimit dhe të kualifikimit profesional. Në bazë të ligjit të nxitjes së punësimin AKPA është institucioni përgjegjës për zbatimin e programeve aktive dhe pasive të tregut të punës.

Struktura dhe organika e AKPA-s në nivel qendror dhe rajonal është e miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 172 date 24.12.2019 “Për miratimin e struktures dhe të organikës se AKPA” . Fondet e nevojshme për pagat e punonjesve dhe sigurimet shoqërore për gjithë sistemin e AKPA-s u përllogariten në bazë të organikës së miratuar dhe legjislacionit te pagave në fuqi. Për Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik për planifikimin e punonjesve me kohë të pjesëshme u morr në konsiderate numri dhe orët mësimore të kërkuara nga institucionet e varesise.

Fondi prej 362.000.000 lekë do të jenë për projektet e mbartura, ndërsa fondi prej 228.000.000 lekë do jetë për projektet e reja që do të miratohen gjatë vitit 2021.

Ndryshimet e bazës ligjore për funksionimin e programit të pagesës së papunësisë bëri që trajtimi i përfituesve të pagesës së papunësisë, të bëhet sipas periudhës së kontributeve të derdhura në sigurimet shoqërore. Mesatarisht numri i personave që përfituan të ardhurën nga papunësia per vitin 2020 është 6.000 përfitues.

Për vitin 2021 janë planifikuar 2.000 përfitues rezervë, në të cilin përfshihen punonjësit që dalin të papunë nga Fasoneri, Shërbime, hoteleri, bar kafe, Alpetrol, OSHEE, Albtelekom, ndërmarrje e kanalizimeve, Arsim, Shëndetësi, Ushtri, reforma territoriale si dhe luhatjet e sektorit privat si pasojë e gjendjes së pa stabilizuar që ka shkaktuar Covid . Totali i përfituesve parashikohet të jetë 6000 persona, por me afate të ndryshme financimi. Nga këta 1.700 persona janë me 3 muaj përfitim, 1.100 persona me 6 muaj përfitim, 900 persona me 9 muaj përfitim dhe 2.300 persona me 12 muaj përfitim.

Fondi që do të nevojitet për funksionimin e programit të pagesës së papunësisë gjatë vitit 2021 do të përbëhet nga:

- niveli bazë i pagesës së papunësisë 13.000 lekë në muaj.
- shtesa familjare ne masen 5% mbi nivelin bazë 650 lekë

Për parashikimet e bëra për zërat mallra e shërbime për Zyrat e Punësimin, Drejtorinë Qendrore të AKPA dhe Drejtoritë e Formimit Profesional u morën parasysh të dhënat historike të përdorimit të fondeve si dhe shpenzimet shtesë që vijnë kryesisht për mirëmbajtjen e programit të shërbimit të punësimin që tenderohet gjatë vitit 2020 por që ka shpenzime mirëmbajtje rreth 30.000.000 lekë për vitet në vazhdim. Në mënyrë analitike janë tabelat shoqëruese të PBA-së.

Për zërin investime i është dhënë prioritet mundësisë së ndërtimit të zyrës së Punësimin Lezhë si rajon i rëndësishëm që ska ambiente pune dhe aktualisht është me qira. Gjithashtu dhe

mundësinë e ndërtimit ose rikonstruksionit të objekteve ekzistuese për zyrat e Drejtorisë Qendrore të AKPAs dhe rikonstruksionit të disa zyrave vendore të punësimit.

### **Prioritetet 2021-2023 në lidhje me sportin dhe rininë**

- Sigurimi i mbështetjes financiare për federatat Olimpikë në aktivitete, Evropiane, Botërore, Ballkanike në funksion të kualifikimeve për Lojërat Olimpikë Japoni 2021, realizimi i 30-35 analizave antidoping për sportistët elitar si dhe ato kandidat për Lojërat Olimpikë Japoni 2021.
- Mbështetja financiare për Ekipin Kombëtar Olimpik pjesëmarrës në Lojërat e Olimpikë Japoni 2021 si dhe aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare për Federatat Sportive, në të gjithat disiplinat sportive, sipas kalendarëve të aktiviteteve në 42 Kampionate Kombëtare, 42 Kupa Shqipërisë, 42 Kampionate Evropiane, si dhe 42 Kampionate Botërore, në përputhje me parimet e barazisë gjinore.
- Mbështetja financiare me investime në sport, për ndërtimin/rindërtimin e objekteve sportive, pajisje me bazë materiale të tyre në funksion të ekipeve kombëtare.
- Zhvillimi i programeve trajnuese në sistemin sportiv kombëtar në funksion të rritjes së kapaciteteve në fushën e sportit, trajnime çdo vit për 20-25% e stafet teknike të sistemit sportiv kombëtar (732 teknike-trainerë, specialistë, instruktorë, mjekë etj, ku përparësi kanë sportistët dhe trajneret femra).
- Rritja e mbështetjes financiare për shpërblimin e sportistëve elitar, fitues në aktivitete ndërkombëtare, mbështetje financiare për 20-25 sportistë elitarë në vit, si dhe mbështetje financiare për aktivitete sportive promovuese dhe garuese në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar dhe universitar.
- Të përmirësojmë cilësinë e jetës së të rinjve, përmes rritjes së pjesëmarrjes së tyre, në punësim, në informim, në edukim dhe në vendimarrje.
- Mbështetja financiare me investime për ristrukturimin/ ndërtimin dhe pajisjen e objekteve për rininë, në funksion të përmirësimit të kushteve për argëtim.

Fondet e planifikuara në programin e sportit dhe rinisë për periudhën 2021-2023 janë në shumën 1.98 miliard lekë nga të cilat; për vitin 2021 janë parashikuar 725 milion lekë, me një rritje prej 1.9 herë të fondeve krahasuar me vitin 2020 ose një rritje 190%, për vitin 2022 janë 676 milion lekë dhe për vitin 2023 janë parashikuar 576.5 milion lekë, pra rritja e fondeve për vitin 2023 krahasuar me vitin 2020 është rreth 130%.

Fondet e programit për “Zhvillimin e Sportit dhe Rinisë 08140”, ndaj shpenzimeve të Ministrisë së Arsimit në vitin 2021 arrijnë në 1.65% dhe në vitin 2023 arrijnë në 1.27%, ndaj shpenzimeve publike 2021-2023, këto shpenzime parashikohet të arrijnë në 0.13 % deri 0.10%, si dhe ndaj produktit të brendshëm bruto në masën 0.04% -0.03%.

- Për periudhën 2021-2023 sigurohet mbështetja financiare ndihmë shtetërore grant për 150-180 milion lekë në vit, për rreth 25 federatave sportive olimpikë dhe joolimpikë,

shpërblimin e sportistëve me rezultate kombëtare dhe ndërkombëtare, shpërblime dhe çmime për sportistët elitar.

- Sigurimi i mbështetjes financiare për federatat Olimpikë në aktivitete, Evropiane, Botërore, Ballkanike në funksion të kualifikimeve për Lojërat Olimpikë Japoni 2021, realizimi i 30-35 analizave antidoping për sportistët elitar si dhe ato kandidat për Lojërat Olimpikë Japoni 2021 me rreth 100 milion lekë.
- Mbështetja financiare për Ekipin Kombëtar Olimpik pjesëmarrës në Lojërat e Olimpikë Japoni 2021 si dhe aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare për Federatat Sportive, në të gjithat disiplinat sportive, sipas kalendarëve të aktiviteteve në 42 Kampionate Kombëtare, 42 Kupa Shqipërisë, 42 Kampionate Evropiane, si dhe 42 Kampionate Botërore, në përputhje me parimet e barazisë gjinore 65 milion lekë.
- Zhvillimi i programeve trajnuese në sistemin sportiv kombëtar në funksion të rritjes së kapaciteteve në fushën e sportit, trajnime çdo vit për 20-25% e stafet teknike të sistemit sportiv kombëtar (732 teknike-trainerë, specialistë, instruktorë, mjekë etj, ku përparësi kanë sportistët dhe trajneret femra) 1 milion lekë.
- Mbështetje financiare për shpërblimin e sportistëve elitar, fitues në aktivitete ndërkombëtare, mbështetje financiare për 20-25 sportistë elitarë në vit, si dhe mbështetje financiare për aktivitete sportive promovuese dhe garuese në institucionet arsimore të arsimit parauniversitar dhe universitar 20 milion lekë.
- Mbështetja financiare me investime në sport, për ndërtimin/rindërtimin e objekteve sportive, pajisje me bazë materiale të tyre në funksion të ekipeve kombëtare 150-200 milion lekë

Programi për Rininë, financim me përparësi për rritjen e pjesëmarrjes së të rinjve në programin e praktikave të punës 150-200 në vit, punësimi në institucione me VKM dhe efektet financiare mbulohen nga ministritë e linjës.

- Mbështetje financiare, për veprimtarinë e Agjencinë e Rinisë dhe të programit kombëtar të praktikave të të rinjve 42,5 milion lekë.
- Mbështetje financiare, për projektet dhe organizatat rinore, sipas prioriteteve të Qeverisë dhe kriterëve të përcaktuara në VKM, me rreth 60 milion lekë;
- Pagesë për kuotën e anëtarësimit në Organizatën Rinore të Ballkanit Perëndimor (RYCO) me 25,2 milion lekë në vit, me synim rritja e pjesëmarrjes së të rinjve në aktivitete me karakter social-kulturor dhe edukativ, rritja e pjesëmarrjes/ mbështetjes financiare të organizatave rinore në projekteve rajonale dhe të BE (RYCO, ERAZMUS +, etj).
- Mbështetja me investime për ristrukturimin/ ndërtimin dhe pajisjen e objekteve për rininë, në funksion të përmirësimit të kushteve për argëtim 100-150 milion lekë; Në këtë periudhë janë planifikuar me prioritet investimeve për rininë për rindërtimin dhe përmirësimin e infrastrukturës të mjediseve për rininë ku parashikohet të përfitojnë 15-20 projekte në vit.
- Financim i huaj për projekte në sport projekti “Be Active +” projekte të tjera në sport dhe projekte rinore, me 100 milion lekë.



Gjatë diskutimeve në komision, deputetët, anëtar të këtij komisioni, bënë pyetje për përfaqësuesit e Ministrisë rreth situatës së pandemisë, rritjes së pagave të mjekëve dhe infermierëve, rreth rritjes së buxhetit të ndihmës sociale, rikonstruksionit të shkollave profesionale, kualifikimit dhe trajtimit të mësuesve për dhënien e mësimit online, zyrave të punës, politikat dhe strategjitë e reja, politikat e të rinjve për punësimet e tyre, matësi i tregut të punës, etj.,

**Komisioni, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm, miratoi në parim projektligjin dhe ra dakord, që, raporti t'i dërgohet Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat, në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.**

**RELATORË**

**Ilirian Pendavinji**

**Edlira Bode**

**KRYETAR**

**Enver Roshi**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË

Tiranë, më 11. 11. 2020

Dokument parlamentar

**(Komision për dhënie mendimi)**

## R A P O R T

### **për projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021” (nen për nen)**

Drejtuar: Komisionit përgjegjës për Ekonominë dhe Financat

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, organizoi në datën 4 nëntor 2020 seancën dëgjimore me shoqërinë civile dhe me datë 10 Nëntor 2020 shqyrtoi nen për nen projektligjin “Për buxhetin e vitit 2021”.

Të ftuar për të marrë pjesë në mbledhjen e shqyrtimit nen për nen të këtij projektligji dhe për t’iu përgjigjur kërkesave për shtesa apo ndryshime në buxhet të paraqitura nga përfaqësuesit e shoqërisë civile ishin përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave

Projektligji “Për Buxhetin e vitit 2021” është propozim i Këshillit të Ministrave bazuar në nenin 81, pika 1 të Kushtetutës së Shqipërisë. Ky projektligj i paraqitet Kuvendit për miratim në zbatim të neneve 78, 83, pika 1 dhe 158 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32-39 dhe 80 të Rregullores, shqyrtoi projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2021”, për pjesën që shprehet për shpenzimet dhe të ardhurat për këto ministri.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit nen për nen, ministrinë përkatëse nuk shprehën kërkesa për shtesa,

Komisioni, bazuar në nenin 36 dhe 80 të Rregullores, zhvilloi një seancë dëgjimore publike, me përfaqësues të ministrive të linjës dhe organizatave jofitimprurëse që veprojnë në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve jetimë, të personave me aftësi të kufizuar, personave që vuajnë nga sëmundja e diabetit, talasemisë, ish-të përndjekurve politikë, organizatave të romëve dhe egjiptianëve, Bashkimit të Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë dhe Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë, etj.

Pasi dëgjoi dhe diskutoi mbi propozimet konkrete të bëra nga përfaqësuesit e organizatave jofitimprurëse të sipërpërmendura, dhe konfirmimit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, e cila siguroi që disa nga kërkesat e ngritura prej tyre janë parashikuar në buxhetin e vitit 2021, por do të vijojnë edhe në buxhetin e vitit të ardhshëm.

#### **Gjatë vitit 2021 programi i kujdesit parësor do të vijojë me:**

- Finalizimin e objektivit të qeverisë shqiptare për ndërtimin dhe rikonstruksionin e 300 qendrave shëndetësore, projekt i filluar në vitin 2018.
- Fillimin e ndërtimit të godinës së re për akomodimin e Qendrës Shëndetësore Nr. 1, NJVKSH dhe Klinikës Stomatologjike Durrës (me një vlerë prej 50 milion lekë).
- Financimin nga Artigiancassa, “Projekti 5 Poliklinikat”, sipas marrëveshjes së nënshkruar më 23.11.2005, për vlerën 5,080,000 EUR ku për vitet 2021-2022 parashikohen të shpenzohen 1.7 milion EUR për Poliklinikat e Gjirokastrës dhe Peshkopisë (ndërtim+pajisje).
- Ndërtimin e qendrave shëndetësore & ambulancave nëpërmjet Fondacionit Gjysmëhena e Kuqe dhe Fondacioni Mirësia-Grant.
- Investimin në qendrat shëndetësore të qarqeve Fier, Dibër dhe Tiranë nga Kooperacioni Zvicëran.

#### **Gjatë vitit 2021 programi i kujdesit dytësor do të vijojë me:**

- Finalizimin e Fazës së II të rehabilitimit të QSUT me fonde të CEB (Banka e Këshillit të Evropës) dhe Qeverisë Shqiptare me një agregat financimi prej 23 milion EUR. Ndërhyrjet në kuadër të këtij projekti përfundojnë në mesin e vitit 2022.
- Rikonstruksionin e Shërbimit të Pediatriisë në QSUT me një financim të Bankës Botërore dhe Qeverisë Shqiptare me një vlerë prej 8 milion EUR. Nënshkrimi i kontratës për fillimin e punimeve është kryer në vitin 2019 dhe objekti parashikohet të përfundojë brenda vitit 2022.
- Blerja e aparaturave mjekësore, mobilim dhe hoteleri vetëm për godinën e re të pediatriisë në vlerën 100 milion lekë, pasi për godinën egzistuese do të kërkohet vlera për pajisjet pas përfundimit të punimeve.
- Financimin e huaj për vitet 2021-2023, i cili është parashikuar të jetë 852 milion lekë për vitin 2021.

#### **Gjatë vitit 2021 objekte në vazhdim do të vijojë me:**

- Rikonstrukcionin e pediatriisë të Spitalit Durrës me një vlerë të kontratuar prej 200 milion lekë. Punimet kanë nisur në Dhjetor 2018 dhe përfundojnë në 6 mujin e parë 2021. Për vitin 2021 janë parashikuar **36 milion lekë**.
- Rikonstrukcionin e Godinës së vjetër të Neonatologjisë dhe Obstetrikës dhe Ndërtimit të dy godinave të reja në SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” me një vlerë prej 803 milion lekë (me TVSH), por meqënëse ky objekt është konsideruar projekt rindërtimi zbritet TVSH, ku për vitin 2021 janë parashikuar 160 milion lekë.
- Për Spitalin Kukës për vitin 2021 janë parashikuar “Furnizim vendosje pajisje teknologjike” për fazën e parë të Spitalit Kukës 45 milion lekë dhe 21 milion lekë për finalizimin e rikonstrukcionit të Fazës së parë.
- Për Spitalin Rajonal Lezhë, vijon rikonstrukcioni dhe shtesa për Maternitetin (me një vlerë totale prej 353.6 milion lekë). Për vitin 2021 është parashikuar finalizimi i këtij investimi duke financuar 218 milion lekë në punime civile dhe 70 milion lekë në pajisje mjekësore.
- Për vitin 2021-2022 do të përfundojë rikonstrukcioni i QKMZHRF me një vlerë prej 145 milion lekë me TVSH) si dhe pajisja hoteliere dhe pajisje mjekësore. Për vitin 2021 do të financohet 54 milion lekë punime civile. Për vitin 2022 do të vijojë financimi i punimeve civile me vlerë prej 84 milion lekë si dhe financimi i pajisjeve mjekësore të hotelierisë me vlerë 40 milion lekë.
- Në 4/mujorin e parë të vitit 2021 përfundon rikonstrukcioni dhe shtesa në Maternitetin e Spitalit Rajonal Berat (me vlerë të kontratuar prej 213.7 milion lekë). Për vitin 2021 do të financohen 61 milion lekë për finalizimin e punimeve civile dhe 60 milion lekë për pajisje mjekësore.

#### **Gjatë vitit 2021 objekte të reja do të vijojë me:**

- Rikonstrukcionin e pediatriisë së Spitalit Rajonal Elbasan me një vlerë të parashikuar prej 333 milion lekë. Financimi i këtij objekti është tre vjeçar, prej të cilave 66.6 milion lekë janë parashikuar për vitin 2021.
- Rikonstrukcionin e sallave të lindjes, repartit të neonatologjisë dhe repartit të urgjencë-pranimit në Maternitetin “Koço Gliozheni” me një fond prej 51 milion lekë, si dhe 20 milion lekë për pajisje mjekësore për reanimacionin neonatal.
- Rikonstrukcionin e bllokut operator të kirurgjisë dhe bllokut të urgjencës të Spitalit Rajonal Shkodër me një vlerë prej 64 milion lekë. Ky financim do të shoqërohet edhe me 15 milion lekë blerje pajisjesh për sallat operatorë.
- Rikonstrukcionin e godinës në Prenjas (pjesë e Spitalit Librazhd) me një vlerë prej 30 milion lekë.

**Gjatë vitit 2021 programi i shëndetit publik do të vijojë me investime për përmirsimin e infrastrukturës të Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor prej 20 milion lekë gjatë vitit 2021**  
**Gjatë vitit 2021 programi i urgjencës mjekësore do të vijojë me blerjen e pajisjeve mjekësore për autoambulanca për Shërbimin Kombëtar i Urgjencave me një vlerë prej 15 milion lekë.**

**Gjatë vitit 2021 programi i përkujdesjes sociale do të vijojë me shpenzimet kapitale për rikonstruksionin e Qendres Sociale në Linze me një vlerë prej 10 milion lekë. Gjithashtu në këtë program për vitet 2021-2023 në zërin “Financimi i Huaj” është programuar vlera prej 300 milione lekë (kryesisht projekti i financuar nga Banka Botërore “Modernizimi i Asistencës Sociale”).**

**Vizita në kujdesin shëndetësor parësor**, ku parashikimi i numrit të vizitave për këtë produkt është bazuar në treguesit e sëmundshmërisë. Në periudhën 2021-2023 parashikohen rreth 6.4 milion vizita për secilin vit. Kosto totale e këtyre vizitave, pjesërisht e mbuluar nga transferata e buxhetit për periudhën në fjalë parashikohet të jetë respektivisht në vite, 2,312,531 mijë lekë (2021), 2,121,531 mijë lekë (2022) dhe 1,863,693 mijë lekë (2023). Ky produkt financohet, përveç transfertës së buxhetit, edhe nga kontributet e arkëtuara të sigurimeve shëndetësore.

**Persona përfitues nga check-up** bazuar në kontratën me konçensionarin numri i personave të grup moshës 35-70 vjeç për të cilët duhet të kryhet pagesa është 475.000. Kosto e kësaj politike nga transferata e buxhetit për çdo vit është 876.090 mijë lekë. Kjo kosto nuk ndryshon për secilin nga vitet e PBA pasi është parashikuar, një vlerë minimum e pagueshme, sipas kushteve të kontratës.

**Pacientë të trajtuar me recetë me rimbursim**, ku aktualisht përfitojnë rreth 400.000 pacientë (e njëjta shifër parashikohet edhe për vitet në vazhdim). Për vitet e PBA parashikohet që sëmundshmëria e trajtuar nga kjo liste të rritet me rreth 6% në vit. Për këtë produkt kosto e politikave ekzistuese nga transferata e buxhetit për secilin nga vitet e PBA është 4,775,379 mijë lekë (2021), 4,755,379 mijë lekë (2022) dhe 5,001,217 mijë lekë (2023).

Buxheti total për shërbimin spitalor për FSDKSH nëpërmjet thesarit është përcaktuar, sipas tavanëve buxhetore, ku për vitin 2021 do të jetë 24,349,217 mijë lekë.

**Pacientë të trajtuar në shërbimin spitalor** për vitin 2021 bazuar në treguesit e sëmundshmërisë, tendenca e numrit të pacientëve do të jetë në rritje afërsisht 320,000 pacientë. Mesatarja e rritjes së numrit të pacientëve për periudhën 2021-2023 është mesatarisht 3% më e lartë se ajo që është parashikuar për vitin 2020. Vetëm për këtë arsye shpenzimet spitalore rriten rreth 10%.

Në produktin “Trajtim i pacientëve në spitale”, përveç përballimit të nevojave të spitaleve në paga, sigurime, mallra e shërbime, përballohen edhe kontrata konçesionare e furnizimit të sallave operatore me instrumenta kirurgjikalë të sterilizuar dhe materiale njëpërdorimshe, sipas kontraktimeve bazuar në partneritetin publik privat nga autoriteti qendror, si dhe financimi i shërbimeve të laboratorit në 5 spitale universitare, 11 rajonale e 2 bashkiake. Parashikohen përkatësisht 1.6 dhe 1.1 miliardë lekë për këto dy kontrata për vitin 2021.

**Pacientë të trajtuar me dializë**, ku përfshihet financimi i shërbimit të dializës për pacientë të trajtuar në spitalet publike e jo publike si dhe pacientët e trajtuar në pesë rajone të vendit nëpërmjet kontratës konçesionare. Kosto totale për këtë produkt, bazuar në seancat që realizohen janë 2.730.000 mijë lekë për 215.000 seanca dialize për vitin 2021.

**Pacientë të trajtuar në Spitalet Psikatrike** ku shpenzimet operative për këto spitale aktualisht janë më pak se nevojat e tyre. Për këtë produkt kosto për vitin 2021 do të jetë 796.697 mijë lekë.

**Pacientë të trajtuar nga paketat e kardiologjisë dhe kardiokirurgjisë**, ku shërbimi ndaj këtyre pacientëve financohet nëpërmjet paketave shëndetësore të miratuara me VKM me çmim të njejtë si në spitalet publike dhe në ato jo publike. në vitin 2021 parashikohet të përballohet financimi për 8.400 pacientë.

**Pacientë të trajtuar nga paketat e transplanteve renale**, shërbim që deri më sot është ofruar vetëm nga spitalet jo publike. Në vitin 2021 parashikohet të përballohet financimi për 26 pacientë, me një kosto prej 36,780 mijë lekë.

**Paketa shëndetësore e trajtimit të kataraktës**, referuar të dhënave të Shërbimit të specializuar, nevojat për trajtimin e kataraktës janë rreth 4.000 raste në vit, me një kosto prej 54,4 milionë lekë. Trendi rritës i numrit të pacientëve të trajtuar është parashikuar me 500 pacientë më shumë për çdo vit. Kosto e llogaritur për vitin 2021 është përkatësisht 82.800 mijë lekë për vitin 2021 (për 4.000 pacientë).

**Paketa e shërbimit të Radioterapisë (Akseleratori Linear)**, realizohen rreth 26,000 seanca seanca me kosto e llogaritur për tre vitet e PBA për këtë produkt, përkatësisht 147,300 mijë lekë, e njëjtë për tre vitet në vazhdim.

**Depistimi i Dëgjimit Neonatal**, produkt i përcaktuar gjatë vitit 2020, ende i pafinancuar në spitale është “depistimi i dëgjimit neonatal”, me një buxhet prej 4,075.5 mijë lekë. Numri i fëmijëve që parashikohen të depistohen është 11,000 për vitin 2021.

Gjithashtu, produkt i përcaktuar nga nevojat aktuale lidhur me përballimin e pandemisë, “pacientë të trajtuar për COVID-19”, nuk është parashikuar për vitet në vazhdim.

**Pacient me Sindromën Down**, ku kosto e llogaritur për vitin 2021 për këtë produkt është përkatësisht 25,000 mijë lekë. Numri i fëmijëve me sindromën down që parashikohen të trajtohen është 25 për vitin 2021,

**Gra te depistuar per kancerin e gjirit dhe qafës së mitrës**, ku parashikohen shpenzimet që Instituti i Shëndetit Publik kryen për depistimin me anë të mamogarfive së lëvizshme. Shpenzimet e këtij produkti janë brenda tavaneve të miratuara. Për vitin 2021 parashikohen të depistohen 5,000 gra. Kosto respektive për secilin vit do të jetë 13,321 mijë lekë.

Këtu parashikohen shpenzimet që Instituti i Shëndetit Publik kryen për depistimin e kancerit të qafës së mitrës. Shpenzimet e këtij produkti janë brenda tavaneve të miratuara. Për vitin 2021 parashikohen të depistohen 14,000 gra, me një kosto prej 32,000 mijë lekë.

**Programi i Përkujdesjes Sociale** në vitin 2021 parashikohet një fond prej 25,479,260 mijë lekë (prej të cilave investime 110,000 mijë lekë).

**PAK dhe kujdestarë që përfitojnë pagesa.** Numri i tyre parashikohet të jete objektiv, duke ulur abuzimet si rezultat i mireadministrimit të programit të pagesave të aftësisë kufizuar si dhe zbatimit skemës së re të vlerësimit sipas modelit bio-psiko-social, bazuar në standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit. Ky sistem i ri vlerësimi synon krijimin e një sistemi shërbimesh integruese, të cilat kombinojnë pagesat me shërbimet e përkujdesit social. Përfitimet e aftësisë së kufizuar do të rishikohen dhe do të mundësohet mbështetja me pagesa më të larta të atyre individëve më aftësi të kufizuar që kanë një gjendje shëndetësore më të rënduar dhe që kanë më shumë barriera për tu përfshirë në jetën shoqërore. Në total, për këtë produkt, për vitin 2021 është parashikuar një fond prej 16,501,635 mijë lekë, për 172 mijë përfitues.

**Përfitues të shërbimeve të përkujdesit social të ofruara në qendrat rezidenciale publike.** Ky tregues përfshin shërbimet e përkujdesit social që përfitojnë shërbim në qendrat rezidenciale publike të përkujdesit social fëmijët në nevojë, të moshuarit në nevojë, gratë e dhunuara, gratë dhe vajzat në rrezik trafikimi. Numri i personave që përfitojnë parashikohet të ulet si rezultat i deinstitutionalizimit, pasi fillimisht synohet transformimi i institucioneve dhe jo shkurtrim buxhetor. Parashikohen tipologji të reja dhe shërbime alternative për kategoritë në nevojë. Numri i përfituesve parashikohet të jete 1,076 për vitin 2021, me një fond prej 1,083,124 mijë lekë.

**Bonusi i Bebes.** Që nga 1 janari i 2019, qeveria shqiptare ka inicuar shpërblimin e lindjes (i diferencuar sipas numrit të fëmijëve të lindur nga nëna: 40,000 lekë për fëmijën e parë, 80,000 lekë për të dytin, 120,000 lekë për femijën e tretë e më shumë). Për tre vitet (2021-2023) parashikohen rreth 30 mijë lindje.

Shpenzimet për vitin 2021 janë parashikuar 2,000,000 mijë lekë.

**Persona nga grupet e pafavorizuara të punësuar nga ndërmarrjet sociale.** Modelimin e ndërmarrjeve sociale si program alternativ riintegrimi për grupet e pafavorizuara. Synimi kryesor është integrimi në tregun e punës të kategorive të ndryshme të grupeve të pafavorizuara nga pikëpamja sociale dhe ekonomike përmes rregullimit të formave të mbështetjes së ndërmarrjeve sociale me një vlerë totale prej 120,000 mijë lekë në vitin 2021.

**Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social.** Nëpërmjet fondit social janë parashikuar fonde për financimin e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, të cilat ngrihen sipas vlerësimit të nevojave të bashkive. Synimi kryesor është ofrimi i shërbimeve sociale territoriale për grupet në nevojë, ku fondet e parashikuara për vitin 2021 janë 200,000 mijë lekë.

**Programi Rehabilitimi i të Përndjekurve Politikë.** Përfshin pagesën që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kryen për këtë kategori bazuar në listat që Ministria e Financave dhe Ekonomisë dërgon. Ky program ka të kostuar këto produkte:

1. **Pagesat e dëmshpërblimit të ish të përndjekurve politikë.**

Kostot për vitet e PBA (2021-2023) janë respektivisht nga 1.000.000 mijë lekë për çdo vit.

2. **Ish të përndjekur politikë të rehabilituar dhe integruar.**

Kostot për vitet e PBA (2021-2023) janë respektivisht 50.000 mijë lekë për çdo vit .

**Gjithashtu në kuadër të luftës kundër pandemisë COVID -19, kemi shtesa mbi tavanet buxhetore si më poshtë:**

1. Shtesë prej 500 milion lekë për shpenzimet operative (art.602) për ISHP në kuadër të luftës kundër pandemisë COVID -19.
2. Për pagat dhe shperblimet e personelit ( Mjek,infermjer) në kuadër të luftës kundër pandemisë 1 miliard lekë
3. Për blerje materialesh mbrojtese (MMP) në kuadër të pandemisë 1.5 miliard lekë
4. Për fonde shtesë për blerje oksigjeni 500 milion lekë.
5. Per Barnat Covid 700 milion lekë
6. Per Vaksinat COVAX COVID-19 kerkohen 1.5 miliard lekë.
7. Per Paga per 700 mjek/infermejere kerkohen 650 milion lekë.
8. Për fond shtese page për rritjen 40 % të pagave të personelit shëndetësor 5.4 miliard lekë.

**Buxheti i planifikuar per Programin e Arsimit të mesëm profesional, per vitin 2021 është 3 miliard e 295 milion lekë me një rritje me 4.1 % më shumë se vitin e kaluar**

**Buxheti i planifikuar per Programin Buxhetor “Tregu i Punës” per vitin 2021 është 2,292,000 milion lekë**

Komisioni, me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm, miratoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin për buxhetin e vitit 2021.

**RELATORË**

**Ilirian Pendavinji**

**Edlira Bode**

**KRYETAR**

**Enver Roshi**